

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2023*

24.04.2023

Ora 11:17

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorëve për kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 13 dhe 14, për vendosje sanksioni administrativ”.

PJESËMARRJA :

- Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 24 prill 2023, ora 11:17 hidhet shorti për caktimin e relatorit, për kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr.13 dhe 14. Kërkesa nr.13 i është drejtuar KAS-it për vendosje sanksioni administrativ ndaj kryetares së Bashkisë Lushnje në masën dhjetë mijë lekë dhe zonjës Erisa Qalliu në masën pesë mijë lekë. Kërkesa nr. 14 ka të bëjë me kërkesën e Komisionerit për vendosje të sanksionit administrativ për propozim gjobe për Klodiana Aliaj Bashkia Tropojë në masën pesë mijë lekë. Procedura e shortit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre ku në dy prej tyre kemi vendosur kërkesat numër 13 dhe 14, të cilat palosen dhe vendosen në gogla me ngjyrë, peshë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezent në seancë, kanë dhënë autorizimin për të tërhequr në emër dhe për llogari të tyre një përfaqësues të KQZ-së, duke filluar nga rendi alfabetik rritës duke filluar me zotin Ervin Lako, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe Ledio Braho. Pesë goglat janë vendosur në një enë transparente pasi përzihen nga përfaqësuesi i KQZ-së:

-Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

Zotit Ervin Lako - Kërkesa e Komisionerit numër 13.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2023*

Zotit Elvis Çefa – shiriti i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Zotit Ilirjan Rusmali: - Kërkesa e Komisionerit numër 14.

-Vazhdojmë në emër dhe llogari të:

Zotit Koli Bele - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në fund, në emër dhe për llogari të:

Zotit Ledio Braho - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Atëherë në përfundim të procedurës së shortit të sotëm, kërkesa numër 13 e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka relator zotin Ervin Lako. Kërkesa e Komisionerit me numër 14 ka relator zotin Ilirjan Rusmali. Ju, faleminderit!

*Zbardi materialin audio
Merita DULAKU*



Rendi i Ditës

**Shqyrtim paraprak i kërkesës nr. 13 të Komisionerit Shtetëror të
Zgjedhjeve, për vendosje sanksioni administrativ.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Lako: Atëherë, çelim sot seancën publike të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për verifikimin dhe plotësimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes për kërkesën nr. 13, paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me objekt: “Kërkesë për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zonjës Eriselda Sefa, kryetare në Bashkinë Lushnjë, me gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë” dhe 2. “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Erisa Qalliu, personi përgjegjës për raportimet e veprimtarive publike me gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë”. Relatori i kësaj seance jam zgjedhur unë, Ervin Lako, sipas shortit të hedhur në dt. 24 prill 2023, në mbështetje të nenit 129, të Kodit Zgjedhor. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, përveç anëtarit, zotit Bele, i cili do të na bashkohet besoj, deri në fund të seancës, Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për sa u përket personave të interesuar, është bërë njoftimi, apo jo zoti Sekretar i Përgjithshëm?

Z. Y. Merkaj: Po, është bërë njoftimi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.04.2023*

Z. E. Lako: Dhe..

Z. Y. Merkaj: Kanë dijeni, nuk janë paraqitur.

Z. E. Lako: Nuk janë paraqitur. Atëherë, vazhdojmë në bazë të procedurës. Ftojme zotin Sekretar të Përgjithshëm të bëjë një përshkrim të shkurtër të ngjarjes dhe çfarë kërkohet nga ana e Komisionerit.

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim nr. 386 ka marrë në shqyrtim administrativ denoncimin me nr. 251, ndaj kryetarit të Bashkisë Lushnjë dhe personit përgjegjës për bashkinë Lushnje, për zhvillimin e një veprimtarie publike të ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri ka konstatuar se është shkelur neni 92 i Kodit Zgjedhor dhe në këto kushte i ka propozuar Komisionit të Ankimimit dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative ndaj zonjës Eriselda Sefa, kryetare e Bashkisë Lushnjë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë dhe t'i propozojë KAS-it, marrjen e masës administrative me gjobë ndaj zonjës Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë. Sipas referuar nenit 45 të rregullores së KAS-it, Komisioneri ka bërë kërkesën Komisionit të Ankimimeve të Sanksioneve për vendosjen e gjobës këtyre personave pasi janë në shkelje të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Ju faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Merkaj. Ka ndonjë pyetje nga anëtarët e KAS-it?

Z. I. Rusmali: Jo.

Z. E. Lako: Atëherë nuk ka pyetje. Zoti sekretar!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 24.04.2023*

Z. Y. Merkaj: Meqenëse i plotëson elementët formalë të nenit 130 të Kodit Zgjedhor, kërkojmë nga KAS-i, kalimin për shqyrtim në seancë publike.

Z. E. Lako: Atëherë, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve i konsultuar në vend, në mbështetje të nenin 126 të Kodit Zgjedhor, për kërkesën e paraqitura nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, meqë përmbush elementet e formës dhe përmbajtjes, pra, plotësohen kërkesat e nenit 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor, vendosi kalimin e këtij ankimi për shqyrtim. Seancën do ta kalojmë direkt për shqyrtimin e çështjes në themel. Palët janë njoftuar apo jo? Atëherë në 15 e 20 afërsisht, do të vazhdojmë me çështjen në themel, dhe ndërkohë do të vazhdojmë me çështjen nr.14, seancën paraprake.

Vendimi nr. 63

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



24.04.2023
Ora 15:06

RENDI DITËS

**Shqyrtim paraprak i kërkesës nr. 14 të Komisionerit Shtetëror të
Zgjedhjeve, për vendosje sanksioni administrativ.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Rusmali: Mirë, çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit nr. 14, “Për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Klodiana Aliaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Tropojë”. Administrata ka bërë njoftimin, nëpërmjet adresës zyrtare të e-malit për personin përgjegjës për zhvillimin e seancës, duke iu ofruar dhe mundësinë e pjesëmarrjes on-line. Siç jam informuar nuk ka reagim nga subjekti. Gjithsesi ne mund ta zhvillojmë seancën edhe në mungesë të palëve. Sot prezent me ne është Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së me ekipin e tij, është dhe trupa e KAS-it. Kërkesa nuk ka, deklarime nga kolegët nuk ka. Atëherë, fillojmë shqyrtimin paraprak të kërkesës duke i dhënë mundësinë Sekretarit të Përgjithshëm të bëjë prezantimin e saj dhe verifikimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë denoncim për organizimin e një veprimtarie publike nga bashkia Tropojë, për të cilën pretendohet se nuk është raportuar si veprimtari publike nga personi përgjegjës

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionit të Ankimimit dhe Sanksioneve
Dt. 24.04.2023*

për raportimet. Denoncimi dhe indicia është marrë nëpërmjet link-ut, të regjistruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Gjatë shqyrtimit administrativ të vendimit nr. 388, dt. 19 prill 2023, ku është shqyrtuar ky denoncim, konstatohet se gjatë zhvillimit të hetimit, personi përgjegjës për raportimin për veprimtaritë publike, megjithëse i është komunikuar nga KQZ-ja për t'iu përgjigjur kërkesës për të dhënë informacion se “Përse nuk është raportuar kjo veprimtari publike?”, nuk i është përgjigjur. Në këto kushte është marrë e mirëqenë që kjo veprimtari është publike dhe nuk është raportuar. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri ka vendosur t'i propozojë KAS-it marrjen e masave administrative për Klodjana Aliajn, person përgjegjës për raportimet për veprimtaritë publike në Bashkinë Tropojë, me masën gjobë, në masën pesë mijë lekë. Nga verifikimi i kërkesës së Komisionierit Shtetëror të Zgjedhjeve, konstatohet se është në përputhje me nenin 130, pasi i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes, dhe si e tillë duhet të kalojë për shqyrtim. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Faleminderit zoti Merkaj! Kolegët ndonjë pyetje? Nuk kanë. Mirë atëherë, kërkesa plotëson elementët formalë që kërkon vendimi për rregulloren e KAS-it dhe ligji për këto kërkesa. Është bërë në përputhje me bazën ligjore që i jep të drejtën KAS-it që të vendosë sanksione mbi propozimin e Komisionierit për rastet e shkeljeve të konstatuara prej tij. Kështu që, KAS-i i konsultuar në vend, merr vendimin që ta kalojë, ta pranojë për shqyrtim këtë kërkesë dhe shqyrtimi i saj do të bëhet menjëherë pas shqyrtimit të kërkesës së Komisionierit, nr. 13. E mbyllim këtë seancë paraprake këtu, për ta riçelur mbas shqyrtimit të asaj kërkesës tjetër.

Vendimi nr. 64

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2023*

**24.04.2023
Ora 15:28**

RENDI I DITËS

***Shqyrtimi në themel i kërkesës numër 13 të Komisionerit Shtetëror të
Zgjedhjeve, sanksionet administrative.***

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Lako: Deklarojmë të çelur seancën e sotme për shqyrtimin në themel të kërkesës numër 13 të depozituar në datën 20.04.2023 nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me objekt, kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Eriselda Sefa Kryetare në Bashkinë Lushnje me gjobë 10,000 lek. Gjithashtu kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Erisa Qalliu person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike me gjobë në masën 5,000 lek. Sipas shortit të hedhur relator jam zgjedhur unë Elvin Lako. Para se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes verifikojmë palët pjesëmarrëse. Për administratën është Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndërsa për palën e interesuar që duhet të jetë Kryetari i Bashkisë Lushnje dhe personi përgjegjës për raportimin, është bërë njoftimi komfort ligjit dhe nuk janë paraqitur. Atëherë edhe në mungesë të tyre sipas nenit 134 pika 4 të Kodit Zgjedhor ne vazhdojmë me shqyrtimin e seancës. Shkurtimisht nga anëtarët e

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2023*

KAS-it ka ndonjë kërkesë paraprake? Jo! Atëherë meqë nuk ka kërkesa paraprake vazhdojmë zoti Sekretar i Përgjithshëm dy fjalë shkurtimisht edhe njëherë për...

Z. Y. Merkaj: Faleminderit. Atëhere Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në datën 07.04.2023 në adresën e postës elektronike të kordinatorit për të drejtën e informimit është informuar për zhvillimin e një veprimtarie publike të raportuar për tu zhvilluar në datën 30 mars 2023, me temë inspektim punimesh palestra e shkollës “Foto Puka” nga Bashkia Lushnje. E cila ishte kategorizuar me vendimin numër 212 datë 28.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si veprimtari e ndaluar për tu zhvilluar. Mbështetur në caktimin e nenit 8 pika 3 të vendimit numër 9 të Komisionit Rregullator u shqyrtua paraprakisht çeshtja për të vlerësuar se të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për tu nisur hetimi administrativ. Në ndërfaqen e KQZ-së në datën 25 mars 2023 Bashkia Lushnje ka raportuar këtë veprimtari publike me objekt inspektim punimesh palestra e shkollës “Foto Puka” për tu zhvilluar në datën 30.03.2023 ora 10:15. Me vendimin numër 212 datë 28.03.2023 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur ndalimin e zhvillimit të pesë aktiviteteve të raportuara për tu zhvilluar në datën 30 mars nga Bashkia Lushnje. Ky ndalim është pasqyruar edhe në ndërfaqen e aktiviteteve të ndaluara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Gjatë shqyrtimit administrativ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacione nga personi përgjegjës për raportimet në KQZ, zonja Erisa Qalliu mbi denoncimin e administruar dhe i kërkojnë informacion në lidhje me njoftimin që është bërë Kryetares së Bashkisë për veprimtarinë e ndaluar të shpallur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Në datën 7.04.2023 nëpërmjet emailit personi përgjegjës për raportimet e veprimtarive të ndaluara, të veprimtarive publike në Bashkinë Lushnje ka vendosur në dispozicion të administratës së KQZ-së shkresën me numër protokolli 2747/1 me

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2023*

lënd vënien në dijeni sipas të cilës Kryetari i Bashkisë zonja Eriselda Sefa është vënë në dijeni mbi veprimtarinë publike të ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve rezultojn se Bashkia Lushnje ka zhvilluar aktivitetin e ndaluar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipar planifikimit të raportuar. Pavarësisht këtij ndalimi zonja Eriselda Sefa, Kryetare e Bashkisë ka zhvilluar aktivitetin e ndaluar ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në këto kushte në përfundim të hetimit administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duke parë që kjo veprimtari dhe ky aktivitet i zhvilluar nga kryetari i bashkisë përbën shkelje të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, bazuar edhe në nenin 171 pika 1 të Kodit Zgjedhor ka vendosur ti paraqesë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve gjobën administrative për Kryetarin e Bashkisë zonja Eriselda Sefa në masën 10,000 lek dhe për përgjegjësën për raportimet e veprimtarive publike të Bashkisë Lushnjë në masën 5,000 lek zonjës Erisa Qalliu. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Merkaj. Pra nga çfarë relatuar në bazë të provave që dispononi në dosje edhe personi përgjegjës edhe kryetari bashkisë kanë pasur dijeni për vendimmarrjen e Komisionerit, për ti cilësuar këto veprimtari të ndaluara dhe as nuk kanë bërë ndonjë ankim ndaj këtij vendimi dhe as nuk e kanë zbatuar atë apo jo?

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. E. Lako: Faleminderit, ka ndonjë pyetje nga kolegët për zotin Sekretar i përgjithshëm?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2023*

Z. I. Rusmali: Mund të bëj një pyetje?

Z. E. Lako: Po, zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Në fakt nuk ka lidhje drejtpërdrejt me kërkesën por me historikun e kërkesës. Kur ju keni bërë hetimin e denoncimit atëhere para se të vendoset ndalimikeni pasur mundësi të hetonin nëse investimi që po kryejej në palestrën e shkollës ishte investim me fonde të çelura përpara apo të çelura në periudhën 4 mujore?

Z. Y. Merkaaj: Nuk është bërë ky hetim por ne thjesht jemi fokusuar si veprimtari publike duke qenë se ka qenë me pjesmarrjën e mediave me drejtuesin politik të qarkut është menduar që është veprimtari publike dhe duhet ndaluar.

Z. E. Lako: Po, zoti Çefa!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Edhe unë kam një pyetje dhe në fakt nuk e di sa mundësi mund të ketë zoti merkaaj të përgjigjet sepse kjo i takon Komisionerit. Zonja Sefa Kryetarja e Bashkisë Lushnje është përsëritëse në këto lloj shkeljesh dhe shoh që Komisioneri qëndron në minimumin e gjobave. Nuk e di a është diskutuar ndoshta apo është menduar që veprimi i kryer, për mendimin tim, sidomos në këtë rast ka pak element më të rënda sesa herët e tjera. Sepse institucioni megjithëse ka pasur dijeni për një akt ndalimi të Komisionerit për këtë veprimtari e ka neglizhuar edhe e ka shpërfillur dhe ka vijuar sikur mos të kishte ndodhur asgjë. Që për mua është rrethanë shumë rënduese në këtë kontekst dhe besoj që masa e gjobës duhet të ishte propozuar pak më e lartë nga Komisioneri. Nëse mund ti përgjigjeni sigurisht.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2023*

Z. Y. Merhaj: Unë mendoj që duke parë rëndësinë e shkeljes Komisioneri përsëri është mjaftuar me minimumin e gjobës. E ka menduar se edhe rast i përsëritur nuk është shkelje shumë e rëndë. Ky ka qenë arsyeimi i Komisionerit.

Z. K. Bele: Kam edhe unë një pyetje, më fal. Duke parë materialet bashkëlidhur shoh që personi i ngarkuar Erisa Qalliu i ka dërguar një email KQZ-së në datën 29 mars, ora 10:50 ku thotë: Përshëndetje, në vijim të njoftimit për ndalimpo ju dergoj emailin që të na lejoni të zhvillojmë aktivitetin pa prezencën e drejtuesit politik. Çfarë qëndrimi është mbajtur për këtë? Pra siç e kuptoj unë dhe siç mendoj e ka kuptuar emaildërguesja, zonja Erisa por edhe siç dhe unë do ta kuptoja, ndalimi vjen për shkak të faktit që në aktivitetin e bashkisë është njoftuar pjesëmarrja e drejtuesit politik. Atëherë në njoftimin që ju kanë bërë bashkisë thuhet: është drejtuesi politik dhe kryetari i bashkisë. Atëhere thoni që ndalimi ska të bëj vetëm me këtë fakt?

Z. Y. Merhaj: Jo vetëm për mospjesëmarrjen e drejtuesit politik por thjesht është veprimtari publike.

Z. K. Bele: Nëse kryetarja e bashkisë do të shkonte të inspektonte një shkollë çfarë problemi duhet të kishte për të cilën do të duhej të ndalohej? Pra a ka ndalim kryetarja e bashkisë të inspektojë një shkollë dhe ta bëj publike?

Z. K. Bele: Dakord por gjithsesi qëndrimi për përgjigjen e këtij emaili që ka drejtuar Bashkia Lushnje është kthyer një përgjigje?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2023*

Z. Y. Merkaj: Atëhere duke qenë se veprimtaria ka qenë e ndaluar dhe nga KQZ-ja është konsideruar e ndaluar nuk ka bërë kompromis dhe nuk është kthyer përgjigje dhe të thotë që meqenëse nuk është drejtuesi politik ti mund të lejohesh të vazhdosh ta zhvillosh.

Z. K. Bele: Dakord, faleminderit.

Z. E. Lako: Po, zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Faleminderit. Zoti Merkaj, Kas-i ka trajtuar raste të tjera të ngjashme me këtë dhe në rastet e tjera të ngjashme atehëre kur veprimtaria ndalohet nga Komisioneri dhe institucioni gjithsesi e zhvillon atë ka njohur eventualisht përgjegjësinë e kryetarit të bashkisë për zhvillimin e veprimtarisë pavarësisht së ajo ishte e ndaluar. Në këto raste KAS-i ka mbajtur qëndrim që përgjegjësia e kryetarit të bashkisë duhet të sanksionohet sipas paragrafit të dytë të nenit 171. Ju vini përsëri me kërkesë që duhet të sanksionohet sipas paragrafit të parë të nenit 171. Mund të bëni një arsyetim mbi këtë kërkesë? Apo thjesht nuk i keni krahasuar me njëra tjetrën.

Z. Y. Merkaj: Është bazuar i gjithë arsyetimi i Komisionerit tek vendimi numër 9 i Komisionit Rregullator të vitit 2020, pikërisht tek neni 10 pika 2 ku thotë titullari i institucionit është përgjegjës për shkeljen e nenit 92 dhe përgjigjet sipas senit 168 dhe 171 të Kodit Zgjedhor.

Z. E. Lako: Dakord, ka ndonje pyetje tjetër? Mirë shkurtimisht, çfarë kërkon nga KAS-i zoti Merkaj?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.24.04.2023

Z. Y. Merkaj: Nga KAS-i kërkojmë vendosjen e sanksioni administrativ ndaj Kryetares së Bashkisë Lushnje zonjës Eriselda Sefa në masën 10,000 lek dhe vendosjen e sanksionit administrativ gjobë për zonjën Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në masën 5,000 lek sipas propozimit të Komisionerit.

Z. E. Lako: Mirë, faleminderit! KAS-i do të tërhiqet për të marë vendim dhe do të rikthehem për 5 minuta.

Rifillon seanca

Ora 15:53

Z. E. Lako: Atëherë riçelim seancën për dhënien e vendimit për kërkesën ankimore numër 13. Në mbështetje të nenit 21, pika 1, shkronja dh të ligjit numër 10,019 datë 29.12.2018 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar KAS vendosi:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zonjës Eriselda Sefa, Kryetare e Bashkisë Lushnje dhe zonjës Erisa Qalliu person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të bashkisë Lushnje.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zonjës Erisa Qalliu person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, Bashkia Lushnje në masën 5,000 lek sipas nenit 171 pika 1 të ligjit 10,019 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
3. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zonjës Eriselda Sefa Kryetare Bashkisë Lushnje në masën prej 2,500 lek sipas nenit 171 pika 1 të ligjit 10,019 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar.
4. Ky vendim do të botohet në faqen zyrtare të KQZ-së dhe hyn në fuqi menjëherë.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2023*

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në kolegjin zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit brenda 45 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Me kaq e deklarojmë të mbyllur.

Vendimi nr. 65

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2023*

**24.04.2023
Ora 15:40**

RENDI I DITËS

***Shqyrtimi në themel i kërkesës numër 14 të Komisionerit Shtetëror të
Zgjedhjeve, sanksionet administrative.***

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Rusmali: Mirë, atëhere rihapim seancën për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit numër 14. Në seancën paraprake pranuar për shqyrtim kërkesën. Prezenca e palëve është si në seancën paraprake, me të njëjtat shkaqe si në seancën paraprake pala, subjekti i interesuar nuk është prezent në seancë gjithsesi ne kemi të drejtën ta zhvillojmë edhe në mungesë çeshtjen. Komisioni është në përbërje të plotë. Ndonjë deklaram paraprak nga anëtarët? Nuk ka! Atëhere ftoj Sekretarin e Përgjithshëm të bëj prezantimin e kërkesës.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë një denoncim për organizimin e një veprimtarie të ndaluar, të një veprimtarie publike të zhvilluar nga Bashkia Tropojë për të cilën pretendohet se nuk është bërë raportimi si veprimtari publike nga personi përgjegjës për raportimin. Ky denoncim dhe indicie është marrë nëpërmjet..... të administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Është konstatuar se Bashkia Tropojë nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një veprimtari publike të regjistruar me numër 156 ID-je ku pretendohet se është zhvilluar një veprimtari në shkollën “Jaho Saliu” në Bujan

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2023*

të malësisë së Gjakovës. Personi përgjegjës për raportimet e vprimtarive të ndaluara gjatë hetimit administrativ është kërkuar që të japë shpjegime dhe nuk ka dhënë asnjë informacion dhe nuk i është përgjigjur kërkesës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në këto kushte referuar dhe pikës 192 të Kodit Zgjedhor janë të detyruar të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik, institucionet publike qendrore dhe vendore si dhe agjensitë ose ndërmarjet shtetërore. Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës. Referuar pikës 1 të nenit 171 të Kodit zgjedhor Komisioneri ka propozuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve të dënohet me gjobë në masën 5,000 lek personi përgjegjës për raportimin e kësaj veprimtarie publike.

Z. I. Rusmali: Mirë, faleminderit zoti Merkaj. Pyetje nga kolegët? Burimi i informacionit, burimi i provës në fakt është postimi në faqen e facebook-ut të zotit Biberaj. Postimi mban datën 3 mars domethënë veprimtaria është zhvilluar relativisht një kohë përpara fushatës zgjedhore. Faqja e internetit e zotit Biberaj është kjo faqja që përdor ai edhe si kryetar bashkie apo ka faqe tjetër zyrtare si kryetar bashkie?

Z. Y. Merkaj: Ndoshta mund të ketë faqe të tjera por nga kërkimi i administratës së KQZ-së del vetëm kjo faqe e cila është e përditësuar në vijimisi.

Z. I. Rusmali: Dakord. Mirë.

Z. K. Bele: Nga sa lexoj, të paktën nga ky pasazh që kemi këtu, kjo veprimtari ka ndodhur me shkollën? Pra kryetari ka shkuar në një shkollë dhe thelbi është pse se ka raportuar që do të shkonte tek kjo shkollë, por nuk është se ka ndonjë...

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2023*

Z. Y. Merkaj: Në përmbajtje të fjalimit nuk është se ka ndonjë....

Z. K. Bele: Unë nuk lexoj ndonjëgjë politike këtu.

Z. Y. Merkaj: Jo, ska gjë politike por nuk është...

Z. K. Bele: Nuk relatohet që të ketë ndonjë drejtues politik, deputet. Nuk ka!
Domethënë kryetari i bashkisë shkon tek një shkollë...

Z. Y. Merkaj: Duhet ta raportojë që sot do të shkojë në një shkollë, do të organizojë një trakim. Nuk e ka bërë këtë! Pikërisht për këtë është dënuar.

Z. I. Rusmali: Mirë, pyetje të tjera? S'ka! Kush është kërkesa përfundimtare e juaja apo doni të trajtojmë atë çështjen e refuzimit për bashkpunim?

Z. Y. Merkaj: Sipas kërkesës së Komisionerit do të caktohet gjobë për personin përgjegjës për raportimet të Bashkisë Tropojë, zonjën Klodiana Aliaj në masën 5,000 lek. Faleminderit.

Z. L. Braho: Të bëj një pyetje. Sot raporton bashkia në vijim apo s'ka raportuar asnjëherë këta?

Z. Y. Merkaj: Jo!

Z. L. Braho: Janë në portal?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.24.04.2023*

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. I. Rusmali: Mirë, e mbyllim këru shqyrtimin, tërhiqemi për të marrë vendim. Vendimi do të shpallet menjëherë pas vendimit me kërkesën e Komisionerit numër 13, mbas 5 minutash.

Rifillon seanca

Ora 15:55

Z. I. Rusmali: Riçelim seancën për dhënien e vendimit për kërkesën ankimore numër 13 të Komisionerit. Deklarojmë vendimin e marrë nga KAS-i lidhur me këtë kërkesë. KAS-i pasi shqyrtojë në tërësi kërkesën vendosi:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zonjës Klodiana Aliaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të bashkisë Tropojë.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zonjës Klodiana Aliaj në masën 5,000 lek sipas propozimit të Komisionerit.
3. Ky vendim do të botohet në faqen zyrtare të KQZ-së dhe hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në kolegjin zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit brenda 45 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Me kaq e deklarojmë edhe këtë seancë të mbyllur. Faleminderit.

Vendimi nr. 66

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

